



## Dokument informimi për muajin dhjetor 2016 nga monitorimi i Kapitullit 23 – jurisprudenca, lufta kundër korrupsionit dhe të drejtat themelore

### I JURISPRUDENCA

#### Paanshmëria

##### 1. Gjykata Themelore Shkup 1 – për herë të dytë u refuzua kërkesa e PSP për lëshimin e urdhrin për kontroll të sistemeve tek operatori i telekomunikacionit

Prokuroria Publike për Ndjekjen e Veprave Penale të ndërlidhura dhe të cilat rezultojnë nga ndjekja e paligjshme e komunikimeve (PSP) njoftoi<sup>1</sup> se Kolegji Penal pranë Gjykatës Themelore Shkup 1, i përbërë nga gjyqtari Vlladimir Pançevski si kryetar i Kolegjit dhe gjyqtaret Dijana Gruevska Ilievska dhe Lubinka Bashevaska, si anëtare të Kolegjit, për herë të dytë refuzoi të lëshoj urdhër për kontroll të sistemeve kompjuterikë tek operatori i telekomunikacionit, duke e konfirmuar mospajtimin të cilin e ka shprehur gjyqtari në procedurë paraprake.

Sipas PSP, Gjykata e përdor arsyetimin e njëjtë për kinse kërkesë të paqartë dhe jo precize, edhe pse në kërkesë në mënyrë të qartë është theksuar se kërkohen të dhëna kompjuterike të ruajtura në serverët, që kanë të bëjnë me regjistrime prej të cilave mund të konstatohet cilat numra telefonikë kanë qenë objekt i ndjekjes së komunikimeve. Sipas PSP, Gjykata pohon se pajisjet për të cilat kërkohet kontrolli “janë serverë portativ, përkatësisht bëhet fjalë për pajisje të cilat mund ta ndërrojnë lokacionin e tyre momental”, pa treguar se në cilat prova e mbështet qëndrimin e këtillë. Ata përkujtojnë se urdhri paraprak për kontrollin e sistemeve kompjuterikë u refuzua pikërisht për kinse jo precizitetin sa i përket lokacionit të serverëve të cilët duhet të kontrollohen, kështu që nuk është e qartë pse Gjykata e ndryshon qëndrimin në lidhje me nevojën e përcaktimit të lokacionit se ku gjenden serverët. Gjykata nuk e demantoi vendimin e as që publikoi komunikatë në ueb faqen zyrtare.

#### Pavarësia

##### 1. Këshilli Gjyqësor

**Në mbledhjen e 240,**<sup>2</sup> Këshilli Gjyqësor miratoi Vendim me të cilin për ushtrues detyre – kryetare të Gjykatës Supreme e përcaktoi Snezhana Bajllazova, gjyqtare në Gjykatën Supreme. Për ushtrues detyre – kryetare të Gjykatës Themelore Shkup 1 u caktua Tatjana Mihajlova, gjyqtare në Gjykatën Themelore Shkup 1.

U miratua edhe Konkluzion sipas iniciativës së gjyqtarit Vlladimir Tufegxhiq nga data 28.11.2016 për rishikimin e vendimit për vlerësimin e jashtëzakonshëm të kandidatëve për kryetar të Gjykatës Supreme,

<sup>1</sup> [http://www.jonsk.mk/2016/12/02/gjykata\\_perseri\\_refuzoi\\_të\\_lëshoj\\_urdhër\\_-3/](http://www.jonsk.mk/2016/12/02/gjykata_perseri_refuzoi_të_lëshoj_urdhër_-3/)

<sup>2</sup> <http://www.ssrn.mk/Novosti.aspx?novost=479>





network23@epi.org.mk

Këtë rishikim e përgaditën anëtarët e Rrjetit 23+, i cili vepron në fushat e përfshira me Kapitullin 23 nga aderimi në BE, gjyqësori dhe të drejtat themelore.



Gjykatës së Apelit Shtip, Gjykatës Themelore Shkup 1 dhe Gjykatës Themelore Tetovë. Sipas Këshillit Gjyqësor, iniciativa është e pabazë.

**Në mbledhjen e 241<sup>3</sup>** u miratuan vendime për vlerësimin e jashtëzakonshëm të kandidatëve për kryetar të Gjykatës Themelore Shkup 1.

**Në mbledhjen e 242<sup>4</sup>** u miratuan vendime për vlerësimin e jashtëzakonshëm të kandidatëve për kryetar të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë, Gjykatës së Apelit Shtip dhe Gjykatës Themelore Tetovë.

## Shërbimi Gjyqësor

### **Sindikata e Punëtorëve të Administratës, Organeve të Jurisprudencës dhe Shoqatave të Qytetarëve të Republikës së Maqedonisë (AOJSH)**

AOJSH publikoi komunikatë<sup>5</sup> në të cilën është theksuar se në mbledhjen e Kryesisë së Sindikatës të AOJSH, të mbajtur më datë 21.12.2016, njëzëri u miratua vendim për përjashtimin e ish-kryetarit të Lidhjes së Sindikatave të Maqedonisë (LSM) Zhivko Mitrevski nga anëtarësia në Sindikatën e AOJSH. Sipas AOJSH, Vendimi nga mbledhja e Kryesisë së Sindikatës është miratuar meqë Zhivko Mitrevski si anëtar i Sindikatës së AOJSH, një periudhë më të gjatë kohore ka vepruar në kundërshtim me Statutin e Sindikatës së AOJSH, nuk i ka respektuar vendimet e miratuara nga organet dhe trupat dhe në mënyrë destruktive ka ndikuar dhe vepruar mbi anëtarët e tjerë të Sindikatës.

## Kompetenca

### **Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë – Trajnime për avokatë dhe gjyqtarë dhe këshilltarë gjyqësorë për ankesat para GJEDNJ në lidhje me të drejtën e pronësisë**

Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë “Pavell Shatev”, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë në kuadër të Projektit Tuining të Letonisë dhe Kroacisë “Përforcimi i sundimit të së drejtës” organizoi dy **Trajnime njëditore për avokatë dhe gjyqtarë dhe këshilltarë gjyqësorë për ankesat para GJEDNJ, si dhe për praktikën rrjedhëse gjyqësore të GJEDNJ lidhur me nenin 1 të Protokollit 1 (e drejta e pronësisë).**<sup>6</sup>

## Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë

### **Lëndët që kanë të bëjnë me parregullsi zgjedhore gjatë kohës së Zgjedhjeve të Parakohshme Parlamentare**

PPRM njoftoi se i monitoron ngjarjet dhe publikimet në lidhje me organizimin dhe zbatimin e zgjedhjeve të 11 dhjetorit të vitit 2016.<sup>7</sup> U formua Komision për monitorimin e parregullsive zgjedhore me detyrë

<sup>3</sup> <http://www.ssrn.mk/Novosti.aspx?novost=481>

<sup>4</sup> <http://www.ssrn.mk/Novosti.aspx?novost=483>

<sup>5</sup> [http://www.upoz.org.mk/index.php?option=com\\_content&view=article&id=420:2016-12-23-11-57-14&catid=1:latest-news](http://www.upoz.org.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=420:2016-12-23-11-57-14&catid=1:latest-news)

<sup>6</sup> <http://www.ipacademy.gov.mk/novosti/--o-----oe-----1---1>

<sup>7</sup> <http://jorm.gov.mk/?p=3715>



Projekti Rrjeti 23+ është i finansuar nga Bashkimi Europian. Qendrimit e shprehura në këtë dokument janë mendime të autorëve dhe jo çdo herë i reflektojnë mendimet e donatorit.





network23@epi.org.mk

Këtë rishikim e përgaditën anëtarët e Rrjetit 23+, i cili vepron në fushat e përfshira me Kapitullin 23 nga aderimi në BE, gjyqësori dhe të drejtat themelore.



që të veproj në të gjitha ngjarjet në të cilat ka indikacione për vepra të kryera penale në lidhje me zgjedhjet. Sipas PPRM, janë formuar gjithsej 42 lëndë. Prej tyre 20 lëndë janë formuar sipas detyrës zyrtare, sipas zërit të dëgjuar nga pretendimet e publikuara në media, në portale dhe në rrjetet sociale. 3 lëndë janë formuar sipas kallëzimeve penale të paraqitura nga persona fizikë. 19 lëndë janë formuar sipas ankesave të paraqitura nga shoqata të qytetarëve, parti politike dhe institucione.

## II LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT

### Kontroll në shtëpinë e kryeshefit të policisë së Kumanovës

Prokuroria Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit informoi se më datë 13.12.2016 në kuadër të procedurës para hetimore, u bë kontroll në shtëpinë e personit S. V. në Kumanovë, kryeshef i SPM Kumanovë.<sup>8</sup> Urdhri për kontrollin e shtëpisë është lëshuar nga Gjyqtari i procedurës paraprake nga Seksioni për Krim të Organizuar dhe Korrupsion pranë Gjykatës Themelore Shkup 1. Qëllimi i kontrollit ka qenë gjetja e gjurmëve të veprës penale ose të lëndëve të rëndësishme për procedurën penale dhe sekuestrimi i tyre. U sekuestruan lëndë që përmbajnë të dhëna në formë të shkruar dhe lëndë që përmbajnë të dhëna në formë elektronike në lidhje me vepra penale – Organizatë kriminale nga neni 394 dhe Shpërdorim të pozitës zyrtare dhe autorizimit nga neni 353 nga Kodi Penal, si dhe vepra të tjera penale për të cilat ndiqet sipas detyrës zyrtare.

## III TË DREJTAT THEMELORE

### Sundimi i së drejtës – E drejta e zgjedhjes

Sa i përket sundimit të së drejtës, vëmendja u fokusua mbi procesin zgjedhor dhe konkretisht mbi ditën e zgjedhjeve. Në këtë kontekst, sipas MPB zgjedhjet kanë kaluar në një atmosferë më të qetë në krahasim me ciklet paraprak, me incidente të vogla dhe të izoluara.<sup>9</sup> Sektori i Punëve të Brendshme Shkup ka paraqitur dy kallëzime penale për dy vepra të kryera penale “Shkatërrim të dokumenteve zgjedhore” kundër dy personave nga Shkupi.

U sekuestruan prova materiale dhe në vijim e sipër është dokumentimi i pesë ngjarjeve juridike penale në rajonin e SPB Strumicë (Vallandovë dhe Strumicë), SPB Veles (Kavadar), SPB Kumanovë dhe SPB Manastir për veprat penale “cenimi i fshehtësisë së votimit”, “cenimi i lirisë së përcaktimit të zgjedhësve”, “pengim të zgjedhjeve dhe votimit”, “shkatërrim të dokumenteve zgjedhore”, “dhunë” dhe “dëmtim të sendeve të huaja.”

Është vepruar edhe ndaj 38 ngjarjeve (Shkup – 20, Manastir – 5, Veles – 5, Strumicë – 4, Veles -2 dhe Tetovë - 2). Prej këtyre lëndëve 7 janë për mitdhënie të pretenduar, 14 janë për agjitim rreth vendeve zgjedhore dhe për shoqërimin e organizuar të votuesve, 5 për fotografimin e fletëvotimit, ndërsa të

<sup>8</sup> <http://jorm.gov.mk/?p=3748>

<sup>9</sup> <http://www.mvr.gov.mk/vest/3176>



Projekti Rrjeti 23+ është i finansuar nga Bashkimi Europian. Qendrimet e shprehura në këtë dokument janë mendime të autorëve dhe jo çdo herë i reflektojnë mendimet e donatorit.





network23@epi.org.mk

Këtë rishikim e përgaditën anëtarët e Rrjetit 23+, i cili vepron në fushat e përfshira me Kapitullin 23 nga aderimi në BE, gjyqësori dhe të drejtat themelore.



tjerat kanë të bëjnë me tentativën e mbushjes së kutive dhe me ofendimin e zëvendës-anëtarit të Këshillit zgjedhor. Pas masave të ndërmarra nga ana e policisë për 22 ngjarje është konstatuar se nuk ka prova për ngjarjet e pretenduara.

## Liria e shprehjes dhe pluralizmi në media

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive ishte aktive në lidhje me monitorimin e periudhës parazgjedhore dhe prezantimit zgjedhor mediatik. U realizua një numër i konsiderueshëm i monitorimeve ndaj punës së më shumë mediave, përfshirë këtu edhe Radiotelevizionin e Maqedonisë dhe televizione e radio të tjera komerciale në nivel nacional dhe lokal.<sup>10</sup>

Agjencia në më shumë raste konstatoi shkelje të Kodit Zgjedhor, më së shpeshti dispozitat e nenit 75 dhe 76 (mbulimi i procesit zgjedhor në mënyrë të drejtë, të balancuar dhe të paanshëm dhe shënimi i reklamimit politik si “reklamim i paguar politik”), si dhe shkelje të Ligjit për media. Në bazë të raporteve të paraqitura nga monitorimi, Komisioni i Përkohshëm për Monitorimin e Prezantimit Mediatik (trupi ad hoc i formuar gjatë kohës së procesit zgjedhor) parashtrroi propozime për veprim në bazë të të cilëve Agjencia ngriti procedura për kundërvajtje kundër radiodifuzerëve, duke iu shqiptuar vërejtje dhe gjopa radiodifuzerëve të cilët i kishin shkelur dispozitat e ligjit. Pas përfundimit të rivotimit në fshatin Tearcë dhe pas përfundimit formal të procesit zgjedhor, Agjencia miratoi vendim për shpërndarjen e Komisionit të Përkohshëm.<sup>11</sup>

## Avokati i Popullit

Në muajin dhjetor të vitit 2016 u nënshkrua Memorandum për bashkëpunim midis Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Maqedonisë – Qendrës për mbështetje e LGBTI dhe Avokatit të Popullit të Republikës së Maqedonisë.<sup>12</sup> Qëllimi i bashkëpunimit është fuqizimi i kapaciteteve rajonale të Avokatit të Popullit në fushën e të drejtave dhe lirive të njeriut të njerëzve LGBTI, si dhe rritja e sigurisë juridike dhe mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave të komunitetit LGBTI në territorin e Republikës së Maqedonisë.

Avokati i Popullit mbajti një konferencë tematike dyditore me temë: “Roli i ombudsmanit në mbrojtjen e fëmijëve refugjatë/migrantë, me mbështetje të Organizatës “Save the Children”.<sup>13</sup> Sipas Avokatit të Popullit z. Ixhet Memeti “Në kushte të mosrespektimit të të drejtave fundamentale të njeriut obligimi ynë ishte që të flasim me zë dhe të kërkojmë nga autoritetet që politikat dhe ligjet të jenë të përshtatura, përkatësisht t’u përgjigjen instrumenteve për mbrojtjen e fëmijës, veçanërisht me Konventën për të Drejtat e Fëmijës, me të drejtën humanitare dhe të refugjatëve.”

## E drejta e privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale

<sup>10</sup> <http://www.avmu.mk/>

<sup>11</sup> [http://www.avmu.mk/images/Odluka\\_za\\_prestanok\\_na\\_mandat\\_na\\_Privremenata\\_komisija.pdf](http://www.avmu.mk/images/Odluka_za_prestanok_na_mandat_na_Privremenata_komisija.pdf)

<sup>12</sup> [http://ombudsman.mk/MK/aktivnosti/231373/potpishan\\_memorandum\\_za\\_sorabotka\\_pomegiu\\_kancelarijata\\_na\\_narodniot\\_pravobranitel\\_i\\_lgbt\\_centarot.aspx](http://ombudsman.mk/MK/aktivnosti/231373/potpishan_memorandum_za_sorabotka_pomegiu_kancelarijata_na_narodniot_pravobranitel_i_lgbt_centarot.aspx)

<sup>13</sup> [http://ombudsman.mk/MK/aktivnosti/231375/narodniot\\_pravobranitel\\_odrzha\\_dvodneven\\_tematski\\_sostanok\\_na\\_tema\\_ologata\\_na\\_ombudsmanot\\_vo\\_.aspx](http://ombudsman.mk/MK/aktivnosti/231375/narodniot_pravobranitel_odrzha_dvodneven_tematski_sostanok_na_tema_ologata_na_ombudsmanot_vo_.aspx)



Projekti Rrjeti 23+ është i finansuar nga Bashkimi European. Qendrimit e shprehura në këtë dokument janë mendime të autorëve dhe jo çdo herë i reflektojnë mendimet e donatorit.





network23@epi.org.mk

Këtë rishikim e përgaditën anëtarët e Rrjetit 23+, i cili vepron në fushat e përfshira me Kapitullin 23 nga aderimi në BE, gjyqësori dhe të drejtat themelore.



Sipas PSP, për çdo ditë rritet numri i kërkesave të cilat qytetarët i adresojnë deri te ata, që kanë të bëjnë me ndjekjen e paligjshme të numrave telefonikë. Deri në muajin dhjetor janë paraqitur gjithsej 81 kërkesa me të cilat qytetarët interesohen të dinë nëse numrat e tyre të telefonit kanë qenë objekt i ndjekjes së paligjshme të komunikimeve. Kërkesat kanë të bëjnë me gjithsej 245 numra telefonikë.

---

### **Korrigjim i Monitorim brif-it për muajin nëntor 2016 nga monitorimi i Kapitullit 23 – Jurisprudenca, lufta kundër korrupsionit dhe të drejtat themelore**

Në Monitorim brif-in e muajit të kaluar u theksua se me monitorimin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive janë përfshirë 18 servise programore. Pas reagimit të Agjencisë,<sup>14</sup> e korrigjojmë këtë të dhënë e cila ka të bëjë vetëm për periudhën kohore nga 11 deri më 20 nëntor, por jo edhe për periudhën nga 1 deri në 10 nëntor. Në mënyrë plotësuese i përfshimë edhe të dhënat për periudhën kohore nga data 21 deri më 30 nëntor (të publikuara nga Agjencia në muajin dhjetor të vitit 2016).

Sipas Agjencisë, me fillimin e fushatës – 21 nëntor, modeli i monitorimit është rritur dhe ka përfshirë 5 servise programore RTM dhe 106 servise komerciale programore. Raporti i Tretë dhjetëditor nga monitorimi, për periudhën kohore nga 21 deri më 30 nëntor të vitit 2016 përfshiu 22 servise programore. Komisioni i Përkohshëm në muajin nëntor, i ka paraqitur Agjencisë gjithsej 49 propozime për veprim. Sipas propozimit të Komisionit të Përkohshëm, Agjencia për kundërvajtjet e kryera për herë të parë, ka ngritur 8 procedura për kundërvajtje për shqiptimin e sanksionit për kundërvajtje – vërejtje dhe 6 procedura për kundërvajtje për shqiptimin e sanksionit për kundërvajtje – gjobë, për kundërvajtje të përsëritura.

---

<sup>14</sup> ASHMAA, Kërkesë për korrigjimin e informacionit, nr. 03-388/1nga data 13.01.2016.



Projekti Rrjeti 23+ është i finansuar nga Bashkimi Europian. Qendrimet e shprehura në këtë dokument janë mendime të autorëve dhe jo çdo herë i reflektojnë mendimet e donatorit.

